Njoftim për përqendrimin me të cilin ALPE HEALTH, shoqëri për investime, d.o.o. Lubjanë, Republika e Sllovenisë, do të fitojë kontroll të pavarur mbi POLIKLINIKA NOBILIS, shërbime shëndetësore d.o.o. Maribor, Republika e Sllovenisë

(Lënda nr. 08-145/2026)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 13.10.2026, pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin **ALPE HEALTH, shoqëri për investime, d.o.o. (ALPE Health, družba za investicije, d.o.o**.), shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli të regjistruar në adresën Rruga „Verovškova“ 55A, 1000 Lubjanë, Republika e Sllovenisë, do të fitojë kontroll të pavarur mbi **POLIKLINIKA NOBILIS, shërbime shëndetësore d.o.o. (POLIKLINIKA NOBILIS, zdravstvene storitve d.o.o.),** shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që funksionon në përputhje me ligjet e Republikës së Sllovenisë, me seli të regjistruar në adresën Rruga „Pohorska“ 21B, 2000 Maribor, Republika e Sllovenisë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe veprimtaritë e tyre afariste:

ALPE HEALTH, shoqëri për investime, d.o.o. është shoqëri sllovene për investime, e themeluar në vitin 2025.

ALPE HEALTH, shoqëri për investime, d.o.o. është në pronësi të plotë të ALFI PE III d.o.o., fond special i investimeve, k.d. (ALFI PE III d.o.o., specialni investicijski sklad, k.d.), fond special i investimeve i cili është themeluar dhe funksionon në përputhje me ligjet e Republikës së Sllovenisë, me seli të regjistruar në adresën Rruga „Verovškova“ 55A, 1000 Lubjanë, Republika e Sllovenisë, i regjistruar në Regjistrin Tregtar në Slloveni.

ALPE HEALTH, shoqëri për investime, d.o.o. dhe ALFI PE III d.o.o., fond special i investimeve, k.d. janë pjesë e Grupit ALFI.

Grupi ALFI është aktiv kryesisht në menaxhimin e investimeve dhe pasurive, veçanërisht në fushat e shitjes me pakicë, mbledhjes së borxheve dhe investimeve të tjera alternative. Grupi ALFI kryen analizën e investimeve (potenciale) dhe menaxhon fondet e investimeve, ndërsa vetë menaxhimi i investimeve pjesërisht u është besuar shoqërive të tjera brenda grupit.

Grupi ALFI është i pranishëm dhe realizon të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes shoqërisë së tij të lidhur në kuptim më të gjerë: APOLLO MK SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në adresën Rruga „Pero Nakov“ nr. 124, Gazi Babë, Shkup, e cila kryen veprimtarinë e tregtisë me shumicë të lojërave, pajisjeve cilësore për fëmijë, aksesorëve për fëmijë dhe produkteve tekstile për fëmijë.

POLIKLINIKA NOBILIS, shërbime shëndetësore d.o.o. është institucion privat shëndetësor i themeluar në vitin 2007 në Slloveni, i cili ofron lloje të ndryshme të shërbimeve shëndetësore. Ajo posedon leje të vlefshme për kryerjen e veprimtarisë shëndetësore në përputhje me Ligjin slloven për Veprimtarinë Shëndetësore.

POLIKLINIKA NOBILIS, shërbime shëndetësore d.o.o. e ushtron veprimtarinë e saj përmes katër njësive afariste që ndodhen në Lubjanë, Maribor, Portorozh dhe Moravske Toplice, ku

veprimtaritë kryesore afariste përfshijnë: veprimtarinë shëndetësore ambulatore dhe kirurgjike, veprimtarinë shëndetësore specialistike jashtëspitalore si dhe trajtimin e kujdesin pas-ambulator të pacientëve.

POLIKLINIKA NOBILIS, shërbime shëndetësore d.o.o. operon kryesisht në tregun e Republikës së Sllovenisë dhe nuk është e pranishme e as nuk realizon të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Sipas parashtruesve të njoftimit, tregu relevant i mallrave në Republikën e Maqedonisë së Veriut do të duhej të përkufizohet si tregu i ofrimit të shërbimeve shëndetësore. Sa i përket shtrirjes gjeografike të tregut relevant të këtij përqendrimi, ai do të mund të përkufizohet si tregu kombëtar, përkatësisht territori i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar mbi këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtje dhe mendime në lidhje me këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr.54, Shkup ose përmes e-mailit: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda afatit prej 10 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

14.10.2026

Shkup